



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

Datë: 07.04.2025
Numër Protokolli: 3079/2025

A.nr.268/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.268/2025, të datës 03.02.2025, të parashtruar nga ankuesi, V.M., kundër organit të punësimit/Komuna e Vitisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A. nr.268/2025, të datës 03.02.2025, të parashtruar nga ankuesi, V.M.

II. Anulohet Konkursi me numër reference RN00015755, për pozitën e punës Zyrtar për Gjendje Civile, i shpallur me datë 08.11.2024, nga Komuna e Vitisë, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

III. Anulohet Vendimi me numër protokolli 02/35/02-1476 i datës 20.12.2024, i Kryetarit të Komunës së Vitisë.

IV. Obligohet Kryetari i Komunës dhe Divizioni i Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë, për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, ashtu sikurse është përcaktuar në piken II të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, V.M. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), kandidat fitues sipas procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015755, të shpallur sipas Konkursit publik të datës 08.11.2024, nga Komuna e Vitisë, për pozitën e punës “Zyrtar për Gjendje Civile”, më datë 03.02.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 777/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.268/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos veprimit të Kryetarit të Komunës së Vitisë, për shkak të mos nënshkrimit të kontratës për themelimin e marrëdhënies së punës apo lëshimit të Akt emërimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.02.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vitisë, ndërsa kjo e fundit, më datë 05.03.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1826/2025 të datës 19.03.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 777/2025 të parashtruar nga ankuesi më datë 03.02.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00015755, për Grupin i Shkencave Shoqërore, gjegjësisht pozitën “Zyrtar për Gjendje Civile” në Komunën e Vitisë, Njoftimin e datës 23.11.2024 të aplikimit; njoftimin për testin me shkrim të datës 16.12.2024; njoftimin për intervistën me goje; Njoftimin e datës 20.12.2024 për shpalljen rezultateve përfundimtare; Kërkesën e datës 27.01.2025; kopjen e letërnjoftimi të ankuesit; Përgjigjen në ankesë të datës 05.03.2025; Aplikacionin e ankuesit të datës 23.11.2024 të bashkangjitur me dokumentet e aplikimit; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe të refuzuar; njoftim për verifikimi paraprak të datës 11.12.2024; Vendimin për themelin e komisionit të datës 04.12.2023; Akt Emërimet e anëtarëve të komisionit; rezultate të testit me shkrim; formularët e vlerësimit individual të interesantëve me goje nga anëtarët e komisionit; Renditja përfundimtare e kandidatëve të datës 20.12.2024; Njoftimi për rezultatin përfundimtar të kandidatëve fitues të datës 20.12.2024; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Vitisë, i datës 20.12.2024 me numër protokoll 02-035/02-1476; Kërkesën e datës 27.01.2025 drejtuar Kryetarit të Komunës së Vitisë; Përgjigjen në kërkesë të datës 29.01.2025, e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e **pabazuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se, Komuna e Vitisë më datë 08.11.2024 ka shpallë Konkursin me numër reference RN00015755, për Grupin e shkencave shoqërore, gjegjësisht një pozitë pune *Zyrtar për Gjendjen Civile*, ku afati për aplikim ka qenë nga data 09.11.2024 deri më 08.12.2024.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 29 kandidatë, ndërsa, prej tyre, kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në liste të ngushtë vetëm 4 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi, i cili ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit nga kjo procedurë rekrutimit, dhe duke qenë se ka arritur gjithsejtë 87.2 pikë të përgjithshme dhe është renditur si kandidati me më së shumti pikë të arritura nga kjo procedurë rekrutimi, i njëjti sipas Njoftimit të datës 20.12.2024, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë, lidhur me rezultatet përfundimtare, është shpallur kandidat fitues për pozitën e punës *Zyrtar për Gjendjen Civile*.

Mirëpo, Kryetari i Komunës së Vitisë, përmes Vendimit me numër protokollit 02-035/02-1476 të datës 20.12.2024, ka anuluar Konkursin publik për pozitën lartë theksuar, atë *Zyrtar i Gjendjes Civile 2-RN00015755* të datës 08.11.2024, si dhe po ashtu ka anuluar konkursin për nëpunës teknik dhe mbështetës-02-111/01-1458 të datës 18.12.2024, duke obliguar me këtë rast sipas pikës II të dispozitivit të këtij vendimi, Njesisë e Burimeve Njerëzore, që ti anuloj procedurat tjera të rekrutimit.

Tutje, Ankuesi, më datë 27.01.2025 ka parashtruar Kërkesë me numër protokollit 02-320/04-2828, tek Kryetari, Nënkyetari dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore i Komunës së Vitisë, për lëshimin e Akt emërimit, për pozitën e punës *Zyrtar i Gjendjes Civile*, pranë Drejtorisë së Administratës të kësaj komune, me arsyetimin se është shpallur kandidat fitues dhe ndaj këtij njoftimit nuk ishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ndërsa, Kryetari i Komunës së Vitisë- Zyra Ligjore, më datë 29.01.2025, ka nxjerrë përgjigjen me numër protokollit 02-070/01-58, përmes të cilës thekson se, Kryetari më datë 20.12.2024, ka nxjerrë vendimin për anulimin e konkursit publik në Komunën e Vitisë dhe se me nxjerrjen e këtij akti bien edhe veprimet procedurale të komisionit, duke theksuar po ashtu se, duke u bazuar në Nenin 51 të Statutit të Komunës së Vitisë, aktet e Kryetarit të Komunës janë përfundimtare-të formës së prerë dhe të ekzekutueshme nga momenti i nënshkrimit dhe protokollimit të tyre.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar, kundër mos veprimit të Kryetarit të Komunës së Vitisë, për shkak të mos nënshkrimit të kontratës për themelimin e marrëdhënies së punës apo lëshimit të Akt emërimit, kërkon nga Këshilli të veprojë mbi bazën e kompetencës duke zgjidhur këtë çështje dhe të njëjtit ti lejohet nënshkrimi i kontratës (Akt emërimit).

Kolegji i Këshillit, në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, si dhe në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka analizuar ligjshmërinë e shpalljes së Konkursit me numër reference RN00015755, për Grupin e shkenca shoqërore, gjegjësisht pozitën e punës *Zyrtar për Gjendje Civile*, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se, organi përkatës i punësimit, si kriteret të përgjithshme formale, në konkursin përkatës të punës ka vendosur: **Arsimimi i kërkuar:** *Fakulteti Juridik; Ekonomik (pa specifikim); Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, dhe Administratë Publike; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku 1 (një) përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.* Si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton se shpallja e konkursit përkatës dhe përcaktimi i kriterit arsimor dhe përvojës së punës, është në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht me Shtojcën Nr.1/6: Përkrahimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 2 dhe Shtojcën Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm-Grupi i Shkencave Shoqërore, si dhe me Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, gjegjësisht për pozitën e përkatëse e cila identifikohet me kod SHC-1118.

Tutje, nga analizimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se ankuesi më datë 23.11.2024, kishte aplikuar në konkursin përkatës, ndërsa lidhur me plotësimin e kërkesave të përgjithshme formale të përcaktuara si më sipër, gjegjësisht lidhur me plotësimin e kriterit arsimor i njëjti ka bashkangjitur, Diplomën me Nr.2698/23, të lëshuar më datë 15.08.2023 nga Kolegji Universum, me të cilin dokument dëshmohej se i njëjti më datë 04.08.2023, ka mbaruar studimet në programin, Biznes Menaxhment, me Specializim në Menaxhment, duke fituar kështu gradën: Bachelor i Arteve në Biznes dhe Menaxhment, me Specializim në Menaxhment, nga rezultoni se ankuesi ka plotësuar kriterin arsimor të lartë theksuar.

Ndërsa, sa i përket plotësimit të kriterit prej një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, ankuesi ka bashkangjitur Kontratën e Punës të datës 01.07.2017 dhe Letër referencën me Nr.Ref:BNJ/05-24/LR, që të dyja këto të lëshuara nga "Q.T Ela-Center" Sh.P.K, dhe se mbi të cilat dokumente, apo thënë më konkretisht sipas letër referencës përcaktohet se i njëjti nga data 05.06.2017 deri më 29.05.2020, ka qenë i angazhuar tek ky punëdhënësi, dhe atë në cilësinë e Kontabilistit, ndërsa sipas kësaj kontrate fillimi i punës është përcaktuar nga data 01.07.2017, deri në afat të pa caktuar.

Rrjedhimisht, ndërlikur me dokumentacionin e bashkangjitur nga ankuesi lidhur me plotësimin e përvojës së punës së kërkuar me shpalljen e konkursit të datës 08.11.2024, Kolegji Këshillit, iu referua praktikës vendimmarrëse dhe të konfirmuar sipas Aktgjykimit A.nr.2276/2014 të datës 24.05.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit A.nr.729/16 të datës 04.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimit AA.nr.367/18 të datës 19.12.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit ARJ-UZVP.nr.77/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku përmes këtyre aktgjykimeve konstatohet se në rastet kur kërkohet përvojë pune profesionale, përvoja e punës së kërkuar duhet të jetë pas diplomimit, nga rezulton se ankuesi nuk ka plotësuar kriterin prej një (1) viti përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, ngase i njëjti siç u theksua edhe më lartë ka diplomuar më datë 04.08.2023, ndërsa faktikisht sipas shkresave të bashkangjitura të lëndës rezulton se ankuesi përvojën e punës e ka para diplomimit, apo konkretisht deri më datë 29.05.2020.

Andaj, nisur nga rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë, si njësi përgjegjëse, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në fazën e verifikimit paraprak, gjegjësisht me rastin e përgatitjes së listës së ngushtë të kandidatëve që plotësojnë kriteret e konkursit, nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe si rrjedhojë gabimisht ka zbatuar ligjin material, ngase për pozitën e punës *Zyrtar për Gjendje Civile*, ka përfshirë në listë të ngushtë kandidatin i cili nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit, si rrjedhojë i njëjti është shpallur edhe kandidat fitues, veprime këto në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 7 dhe 8, ku përcaktohet se: *7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve; 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi*, ndërlikur me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të këtij Ligji.

Tutje, Kolegji i Këshillit, nga analizimi i Vendimit me numër protokollit 02-035/02-1476 të datës 20.12.2024, të Kryetarit të Komunës së Vitisë, përmes të cilit i njëjti ka anuluar Konkursin publik për pozitën lartë theksuar, atë *Zyrtar i Gjendjes Civile 2- RN00015755* të datës 08.11.2024, si dhe po ashtu ka anuluar konkursin për nëpunës teknik dhe mbështetës-02-111/01-1458 të datës 18.12.2024, konstaton se ky akt administrativ për nga përmbajtja dhe arsyetimi nuk ka mbështetje në dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafi 2 të Ligjit 05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, ngase i njëjti nuk ka shpjeguar qartë situatën faktike mbi të cilën është marrë vendimi, si dhe po ashtu i njëjti akt është në kundërshtim edhe me paragrafin 2 të këtij neni, i cili përcakton se: *“2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshëm apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”* dhe si i tillë konsiderohet i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për rrjedhojë e njëjti është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi e nuk plotëson kriterin e përvojës së punës, si rrjedhojë dhe shpallja e të njëjtit kandidat fitues është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, dhe kjo ka bërë që procedura e rekrutimit të zhvillohet në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku është përcaktuar se: *“1. Pranimi në detyrë i nëpunës/it civil, nëpunës/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunës/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese”*, dhe se për shkak të shkeljeve të evidentuara si më lartë kjo

procedurë e rekrutimit konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si më sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për refuzimin e ankesës si të pabazuar, anulimin e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015755 dhe anulimin vendimit me numër protokollit 02-035/02-1476 të datës 20.12.2024, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.268/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit V.M.;
- Kryetarit të Komunës dhe Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.